



Republika e Kosovës
Republika Kosovo -Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Kryesia e Kuvendit

P-016
Prishtinë, më 10 maj 2011, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

P R O C E S V E R B A L

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, TË MBAJTUR MË 10 MAJ 2011

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, Kryetar i Kuvendit, Sabri Hamiti, Glauk Konjufca, nënkryetarë të Kuvendit;

Nga Grupet Parlamentare: Adem Grabovci, Ismet Beqiri, Visar Ymeri dhe Ardian Gjini.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i Kryetarit të Kuvendit: Skënder Reçica;

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Sherif Konjufca.

Nga OSBE-ja: Floriana Shala.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, Kryetar i Kuvendit.

Kryetari hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit e ditës.

Ai propozoi që rendit të ditës t'i shtohen edhe dy pika shtesë.

Kryesia, me propozim të kryetarit, miratoi këtë:

R e n d d i t e

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 3 maj 2011,
2. Propozimi i rendit të ditës për mbledhjen e ardhshme plenare,
2. Shqyrtimi i mocioneve, të rekomandimeve dhe të kërkesave.

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 3 maj 2011

Kryesia miratoi, pa vërejtje, Procesverbalin e mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 3 maj 2011.

2. Propozimi i rendit të ditës për mbledhjen e ardhshme plenare

Kryesia, pasi shqyrtoi përgatitjet e nevojshme për secilën pikë veç e veç, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare vendosi që Kuvendi t'i mbajë dy mbledhje plenare.

Më 12 maj 2011, me këtë:

R e n d d i t e

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes plenare të mëparshme,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për bashkëpunim ndërkomunal dhe partneritete,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2002/5 për themelimin e regjistrit të të drejtave të pronës së paluajtshme,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Këshillin Ekonomiko – Social,
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për organizimin sindikal në Kosovë,
8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për mbrojtje nga zjarri,
9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim,
10. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Kadastër.

Më 19 maj 2011, me këtë:

Rend dite

1. Shqyrtimi i Raportit të auditimit të pasqyrave financiare të Komisionit të Pavarur për Media, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2010,
2. Propozim - Rregullorja për zgjedhjen dhe shkarkimin e Avokatit të Popullit dhe zëvendësve të Avokatit të Popullit,
3. Kërkesa e deputetit Nait Hasani, me mbështetje të grupit nënshkrues, për debat parlamentar lidhur me masakrën në burgun e Dubravës, me arsyetim,
4. Shqyrtimi i Raportit vjetor i Rregullatorit për Ujëra dhe Mbeturina, për vitin 2010,
5. Shqyrtimi i Raportit të punës të Agjencisë kosovare kundër Korrupsionit, për vitin 2010.

Rendit të ditës të kësaj mbledhjeje mund t'i bashkëngjiten edhe pika të tjera, të cilat mund të përgatiten ndërkohë.

3. Shqyrtimi i mocioneve, të rekomandimeve dhe të kërkesave

3.1 Njoftim për skadimin e afatit të mandatit të një anëtari të Bordit të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me njoftimin e cekur më lart, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Kërkohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës që ta inicojë procedurën për zgjedhjen e një anëtari të Bordit të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale dhe Propozim-vendimin lidhur me të t'ia dërgojë Kuvendit.

3.2 Lejimi i shpenzimeve për vizitën në Kosovë të delegacionit të Parlamentit Holandez- Komisioni për Çështje Evropiane, prej 10-12 maj 2011

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me këtë çështje, mori këtë:

VENDIM

Lejohen shpenzimet e një dreke zyrtare dhe të transportit lokal gjatë vizitës të cilën do ta realizojë në Kuvendin e Republikës së Kosovës delegacioni Parlamentit Holandez-Komisioni për Çështje Evropiane, prej 10-12 maj 2011.

3.3 Lejimi i shpenzimeve për Nënkryetarin e Kuvendit të Kosovës z. Xhavit Haliti

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me këtë çështje, mori këtë:

VENDIM

1. Lejohet udhëtimi zyrtar i nënkryetarit të Kuvendit, z. Xhavit Haliti, në Tiranë, prej 27 deri 29 maj 2011.
2. Të gjitha shpenzimet e qëndrimit për të lartpërmendurin, sipas paragrafit një (1) të këtij vendimi, përballohen nga buxheti i Kuvendit.

3.4 Njoftim lidhur me ftesën e Komisionit Evropian për vizita studimore në Bruksel, për 24 deputetë të Kuvendit të Kosovës

Kryesia u njoftua me ftesën e Komisioni Evropian, që i ka ftuar 24 deputetë të Kuvendit të Kosovës, nga të gjitha grupet parlamentare.

3.5 Njoftimi i Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike lidhur me përzgjedhjen e auditorit të jashtëm për auditimin e pasqyrave financiare të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, për vitin 2010

Kryesia u njoftua me vendimin e Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike lidhur me përzgjedhjen e auditorit të jashtëm, që kishte përzgjedhur Kompaninë Audituese “**BDO KOSOVA**”, për auditimin e pasqyrave financiare të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, për vitin 2010.

3.6 Kërkesa e kryetarit të Komisionit për Integritet Evropian për Lejimin e udhëtimit zyrtar në Shqipëri, prej 16 -17 maj 2011

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e cekur më lart, mori këtë:

VENDIM

1. Lejohet udhëtimi zyrtar i Komisionit për Integritet Evropian, në Durrës-Shqipëri, prej 16-17 maj 2011, në këtë përbërje: Lutfi Haziri, Xhavit Haliti, Sasha Milosavljeviç, Blerta Deliu Kodra, Fatmir Limaj, Vjosa Osmani, Suzana Novoberdali dhe Albert Kinolli, anëtarë të Komisionit, si dhe Ahtere Loxha dhe Safet Beqiri, staf mbështetës i Komisionit.

2. Shpenzimet e qëndrimit dhe akomodimit për të lartpërmendurit, sipas paragrafit një (1) të këtij vendimi, mbulohen nga organizatori, ndërsa mëditjet përballohen nga buxheti i Kuvendit.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në orën **11:30** minuta.

Kryetari i Kuvendit,
Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi: Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale.